

## INCOSAI XXI

Pekin, tetor 2013

Organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kinës



*Pjesëmarrësit në kongresin e njëzetënjëtë INCOSAI.*

INCOSAI i njëzetënjëtë, i mbajtur në Kinë, më 22-26 tetor 2013, mbledhi rreth 600 delegatë nga 192 institucione supreme të auditimit, anëtare të INTOSAI-t.

Fjala e hapjes në Ceremoni u mbajt nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit, i cili bëri një paraqitje të plotë të aktiviteteve dhe veprimtarisë së INTOSAI, të projekteve dhe lidhjeve të bashkëpunimit midis INTOSAI dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare si OKB dhe Banka Botërore dhe fryma dhe mesazhet që ky institucion ka përçuar tek gjithë SAI-t e tjera përgjatë tre viteve.

Zv/Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Wu Hongbo përcolli mesazhin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Ban Ki Moon dhe siguroi në vazhdimësinë e mbështetjes së projekteve të rëndësishme të INTOSAI-t nga ana e Kombeve të Bashkuara.

Kryeministri i Republikës Popullore të Kinës, z. Li Keqiang, përçoi mesazhin e rëndësishëm të ndikimit të SAI-ve në rritjen e cilësisë së mirëqeverisjes, sidomos në këto ditë të vështira ku kriza ekonomike financiare është më e pranishme se kurrë.

Kongresit prezantoi dy tema kryesore, “Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare”, si dhe “Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë së Politikave Financiare”.

Në seancën e parë plenare, u paraqitën raportet e grupeve të punës, komisioneve dhe Task Forcës së INTOSAI-t në lidhje me arritjet e tyre. Ndër këto raportime spikatën raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Moser, Raporti i Komisionit të Administrimit dhe Financës; i Task Force të INTOSAI-t për Mbikëqyrjen Financiare; Raporti mbi Veprimtaritë me Bashkëpunimin e Donatorëve të INTOSAI-t, etj.

Gjatë diskutimeve për temën e dytë të Kongresit “Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë së Politikave Financiare”, spikati fjala e mbajtur nga Ambasadori Martin Sajdik, Zv/President i Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, i cili vuri theksin në forcimin e kontributeve kombëtare dhe ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe SAI-ve të vendeve të ndryshme

për promovimin e qëndrueshmërisë së financave publike. Qëndrueshmëria e financave publike ka qenë në axhendën e INTOSAI-t duke filluar nga viti 1991, kur filloi punimet Komisioni i INTOSAI-t mbi Borxhin Publik, i cili u transformua në Grup Pune në vitin 2007. Fokusi i INTOSAI-t mbi këtë temë u thellua edhe më tepër si pasojë e krizës financiare: arsye për të cilën u krijua në vitin 2008 Task Force mbi Krizën Globale Financiare, i cili u përfshi në vitin 2012 në Grupin e Punës mbi Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore. Menaxhimi i shëndoshë i financave publike dhe politikat financiare të përshtatshme japin pa dyshim një kontribut të rëndësishëm në krijimin e zhvillimeve ekonomike me inflacion të ulët dhe klimë financiare të favorshme, që me kalimin e kohës ndihmojnë në hartimin e planifikimeve afatgjata dhe të investimeve. Për këto arsye, INTOSAI inkurajon anëtarët e tij të përdorin influencën e tyre, për të promovuar një harmonizim të kornizave të raportimit financiar në sektorin publik, duke dhënë kështu më tepër transparencë në lidhje me veprimtaritë e qeverisë, në veçanti për sa i përket borxhit qeveritar.

Diskutimet e mëtejshme në lidhje me temat e Kongresit u zhvilluan në tre seanca plenare të anëtarëve të INTOSAI-t, në fund të të cilave u procedua me votimin dhe aprovimin e përfundimeve të të dyja këtyre temave, që i janë aneksuar Deklaratës së Pekinit.

Deklarata e Pekinit përmbledh arritjet historike dhe përvojën themelore të 60 viteve të fundit, si dhe rezultatet e dy temave teknike. Aty shtjellohen rezultatet e punës, misionit, vlerave themelore, dhe vizionit të SAI-ve, si dhe zbulohen mënyrat, përmes të cilave INTOSAI po synon të bëhet një organizatë ndërkombëtare model për promovimin e qeverisjes globale. Për më tepër, aty riafirmohet rëndësia e adoptimit dhe zbatimit të planifikimit strategjik të konfirmuar edhe në vizionin e INTOSAI-t, si dhe vlerat thelbësore në këtë epokë të re të zhvillimit historik; aty vihet në dukje rëndësia e shkëmbimit të përvojës, rritja e kapaciteteve, si dhe bashkëpunimi me donatorët; dhe paraqiten rezultatet e Grupit të Punës të INTOSAI-t mbi vlerat dhe dobitë e SAI-ve, së bashku me rezultatet e tjera.

Si dokumenti përmbledhës dhe përfundimtar i Kongresit të 21 të INTOSAI, Deklarata thekson se situata globale me të cilën institucionet supreme të auditimit përballen i çon ata drejt përmirësimit të qeverisjes kombëtare, duke intensifikuar mbikëqyrjen, rritjen e transparencës dhe të paanësisë, promovimin e performancës dhe intensifikimin e luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu qëndrueshmëria afatgjatë e politikave financiare të shteteve është një element përbërës dhe parakusht për një mirëqeverisje efektive. Kjo qëndrueshmëri mund të arrihet nëpërmjet auditimit profesional dhe të pavarur, i cili është elementi kryesor i zinxhirit të auditimit të performancës së financave publike. Kjo Deklaratë, së bashku me dokumentet e tjera të miratuara nga kongreset e mëparshme (si Deklarata e Limës dhe e Meksikës) do të sigurojë udhëzime për zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t dhe SAI-ve anëtare. SAI-t do të vazhdojnë të shërbejnë shoqërinë dhe publikun duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e mirëqeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reforma. Falë kësaj deklarate, SAI-t duhet të orientohen drejt adoptimit të mjeteve dhe metodologjive audituese krijuese, duke marrë masa efektive për të rritur aftësitë e tyre, dhe për të kapërcyer sfidat e botës moderne.